



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 46
Prishtinë, më 18.11. 2009, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Morën pjesë: Ismet Beqiri – kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviq, Nerxhivane Dauti, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Danush Ademi dhe Shpresa Murati.

Mbledhjen e mbikëqyrën: Rrezarta Ahmeti – KDI, Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit dhe Petrit Hysa - OSBE.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator dhe Visar Krasniqi.

***Kryetari** konstatoi se ish-in plotësuar kushtet, në bazë të Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi këtë:*

R E N D D I T E

- 1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
- 2 Shqyrtimi i shpenzimeve të Komisionit për vitin 2009,
- 3 Shqyrtimi i peticionit nr. 03-2830/2-D-1791 të datës 26.10. 2009
- 4 Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar,

2. Shqyrtimi i shpenzimeve të Komisionit për vitin 2009

Ismet Beqiri, kryetar - E njoftoi Komisionin për shumën e shpenzimeve të Komisionit dhe destinimin e tyre. Ai tha se me kohë do të kërkojmë shtimin e tyre dhe do t'i paraqesim planifikimet dhe destinimet.

3. Shqyrtimi i petitionit nr. 03-2830/2-D-1791 të datës 26.10. 200

Kryetari e ftoi raportuesen ta merrte fjalën dhe t'i njoftonte anëtarët e Komisionit për përmbajtjen e ankesave.

Nerxhivane Dauti – Tha se duke u mbështetur në nenin 21 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në rregulla të Rregullores së punës të Kuvendit, Komisioni e shqyrtoi petitionin e banorëve të komunitetit boshnjak të Vitomiricës KK Pejë, lidhur me botimin e librit të dr. Numan Baliqit me titull “Udhëtimi”. Ajo shtoi se nënshkruesit e petitionit theksojnë se libri përmban formulime fyese për femrat boshnjake dhe i paraqet ato si “dëfryese të çetnikëve” dhe bashkëpunëtore të regjimit serb. Kjo shkakton pakënaqësi brenda komunitetit boshnjak, prandaj në bazë të rregullës 41 të Rregullores së punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës i propozoj Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me petitionin, të nxjerrë këtë:

P e r f u n d i m

Komisioni konstatoi se çështja e ngritur nuk bie në fushëveprimin e tij, prandaj rekomandon që për realizimin e të drejtave të tyre t'i drejtohen gjykatës kompetente.

4. Të ndryshme

Nerxhivane Dauti - Kërkoj që para vizitës në Poloni anëtarët e Komisionit të pajisen me legjislacion përkatës ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut.

Ibrahim Makolli – Tha se Komisioni gjatë vizitës në Odir duhet të përqendrohet në dy fusha: të Drejtat e njeriut dhe institucionet demokratike. Për nevojën e sigurimit të ligjeve që dalin nga Pakoja e Ahtisaarit dhe të zgjedhjeve, veçmas u ndal në disa ligje që i mbrojnë komunitetet e tjera. Kosova si shtet i ri ka arritur shumë në mbrojtjen juridike të komuniteteve joshqiptare. Në këtë fushë do të bëja një përmbledhje për gjendjen e të drejtave të njeriut në raport me Kushtetutën dhe me mekanizmat e tjerë relevantë, duke vënë në fokus të drejtat e pakicave. Sigurisht ka mangësi, por Kosova në këtë aspekt ka një avancim të dukshëm, sepse ekziston një mori mekanizmesh ndërkombëtarë me të cilët mbrohen të drejtat e pakicave, pra ka bazë të mirë ligjore, kurse çështje tjetër me rëndësi që do të inicohet janë zgjedhjet. Me anë të zgjedhjeve realizohet zhvillimi i demokracisë. Në fund theksoi se si Komision do të kërkojmë mbështetje në ngritjen e kapaciteteve të Komisionit. Në këtë mënyrë ngriten edhe kapacitetet në Kuvendin e Kosovës, qoftë me ekspertiza ose në forma të tjera, se është një nga vendet më të avancuara në këtë fushë.

Luljeta Shehu – E ngiti çështjen e Projektligjit për personat e pagjetur që ende Qeveria nuk e ka proceduar në Kuvend. Ajo e theksoi edhe

shqetësimin e disa pensionistëve të Krushës së Vogël, të cilëve u ndalen nga 10 euro, prandaj kërkojnë sqarim nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale.

Ishte konstatim i përgjithshëm i Komisionit se para se t'i dërgohet Qeverisë kërkesa, të verifikohet ndalesa e kësteve. I kërkoj arsyet e ndaljes dhe përsëritjen e kërkesës së procedimit të projektligjit.

Mbledhja përfundoi
në orën 14: 00

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri